

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6545  
E shtunë, 26 shkurt 2022  
çmimi 0.40 €

## Kosova miraton pakon e sanksioneve kundër Rusisë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI MBAN SEANCË PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

## OPOZITA I KËRKON QEVERISË FOKUSIM NË MARRËVESHJEN PËRFUNDIMTARE ME SERBINË



Deputetë të partive opozitare kanë kërkuar të premtën nga qeveria që ta ndërpresë dialogun teknik me Serbinë dhe t'i vazhdojë bisedimet e nivelit të lartë me qëllim të arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, si kërkuar në kësaj seance, ka thënë se çështja e dialogut është interes kombëtar por, sipas tij, udhëheqësit e sotëm të vendit, që dikur e kundërshtonin ashpër dialogun, sot krenohen për dialogun e teknikëve me tema të ricikluara. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se kjo qeveri e ka marrë shumë seriozisht dialogun me Serbinë

### AKTUALE



NË 18 RASTE GJYKATAT THEMELORE KANË SHQIPTUAR DËNIME MINIMALE

F.7

KOSOVA REGJISTRON TRI VIKTIMA DHE 140 RASTE TË REJA ME COVID

F.7

MIRATOHET PROGRAMI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MSA-së 2022-2026

F.5

KRYETARI I OBILIQIT SHUAN INICIATIVËN DHE KALON NË LDK

F.7

### EKONOMI



RRITET SËRISH ÇMIMI I NAFTËS

F.8

"ASNJI CENT MA SHUMË", PROTESTUESIT KËRKOJNË ANULIMIN E VENDIMIT PËR NGRITJEN E RRYMËS

F.8


### SPORT



MARMARINOS: DUAM TË BËJMË MË TË MIRËN PËRBALLË NORVEGJISË

F.10

## ZELENSKY I BËN THIRRJE PUTINIT TË NEGOCIOJË: TA NDALOJMË VRASJEN E NJERËZVE



Ukraina: 2,800 viktima ruse që prej fillimit të pushtimit

Pushtimi i Kievit, digjet ndërtesa e Shërbimit të Sigurisë së Ukrainës

Trupat ukrainase krijojnë postbllogje përgjatë autostradës së Kievit për të penguar hyrjen e ushtrisë ruse

Banorët e Kievit kapin armët, derisa Rusia vazhdon pushtimin



REUTERS

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mbr: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Zelensky i bën thirrje Putinit të negociojë: Ta ndalojmë vrasjen e njerëzve

**KIEV, 25 SHKURT** - Shpërthime u dëgjuan mbi kryeqytetin ukrainas herët të premtën, në ditën e dytë të sulmit në shkallë të gjerë të Rusisë në Ukrainë.

“New York Times” raportoi se kishte “vërtetuar” video të shpërthimeve që “duket se tregonte të paktën dy raketa tokë-ajër që u hodhën pranë Kievit përpara shpërthimit”.

Sirenat e alarmit u dëgjuan edhe në qytetin perëndimor të Ukrainës, Lviv, jo shumë larg kufirit polak, ku janë zhvendosur për kohësisht shumë ambasada të huaja.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka bërë thirrje homologut të tij rus, Vladimir Putin, që të negociojnë. Pasi vlerësoi trimërinë e trupave ukrainase, Zelensky në rusisht i bëri një thirrje të drejtpërdrejtë Putinit. “Do të doja t’i drejtohesha edhe një herë presidentit të Federatës Ruse. Lufta po vazhdon në të gjithë territorin e Ukrainës. Le të ulemi në tryezën e bisedimeve për ta ndaluar vrasjen e njerëzve”, ka deklaruar Zelensky.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, ka thënë të enjten në mbledhje se trupat ruse, duke hyrë nga Bjellorusia, kishin përparuar deri në 32 kilometra larg Kievit.

Në Ukrainën veriore trupat ruse morën kontrollin e centralit të Çernobilit të enjten. “Kjo është një deklaratë lufte kundër të gjithë Evropës”, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky.

Çernobili është vendi i shpërthimit më të keq të centralit bërthamor në botë. Çernobili dhe zona përreth tij kanë mbetur të pabanueshme që nga fatkeqësia e vitit 1986.

Protestuesit kundër luftës u hodhën në demonstrata në të

gjithë Rusinë, duke përfshirë Moskën dhe Shën Peterburgun, të enjten. Zyrtarët thonë se të paktën 1 700 njerëz u arrestuan.

Presidenti amerikan Joe Biden njoftoi një raund të ri sanksionesh ndaj Rusisë pas sulmit ndaj Ukrainës, duke akuzuar udhëheqësin rus Vladimir Putin se “e zgjodhi këtë luftë” dhe se vendi i tij do t’i bartë pasojat e veprimeve të tij.

Aleatët e NATO-s, përfshirë Britaninë dhe Bashkimin Evropian, vendosën sanksione të reja të enjten, po ashtu.

Sulmi rus mbi Ukrainën është sprovë më e madhe e sigurisë së Evropës që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Në një fjalim televiziv nga Kremli para agimit të së enjtes, presidenti e quajti atë një “operacion ushtarak të posaçëm” që synon “çmilitarizimin dhe denacifikimin” e Ukrainës, dikur një republikë sovjetike, por një vend i pavarur që nga viti 1991.

Ndërsa nata po binte në Evropë, ministri i Shëndetësisë i Ukrainës, Viktor Lyashko, tha se 57 ukrainas janë vrarë dhe 169 janë plagosur.

Sipas zyrtarëve amerikanë, gjatë sulmit rus, ende në fazën fillestare, u shënjestruan pozicionet e mbrojtjes ukrainase me më shumë se 160 raketa balistike me rreze të shkurtër dhe të mesme veprimi dhe sulme ajrore nga avionët.

## Protesta në Rusi kundër luftës me Ukrainën

Shumë protestues kundër luftës u mblodhën të enjten në mbledhje në Moskë duke kundërshtuar ndërhyrjen ushtarake të vendit të tyre në Ukrainë.

Protestuesit hodhën parulla



kundër luftës dhe presidentit Vladimir Putin.

Policia arrestoi disa demonstrues gjatë protestës.

Sipas organizatës për të drejtat e njeriut OVD-Info, më shumë se 1 450 protestues në 51 qytete në të gjithë vendin janë arrestuar nga autoritetet ruse. Demonstratat u zhvilluan në vende të tilla si Shën Petersburg, Novosibirsk dhe Yekaterinburg.

## Erdogani: Të gjithë japin këshilla, por NATO duhet të veprojë më me vendosmëri

Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan është shprehur se NATO-ja nuk ka treguar vendosmërinë e nevojshme për situatën e krijuar në Ukrainë dhe se qëndrimi i Perëndimit ndaj saj nuk është aspak miqësor. “Perëndimi, BE-ja dhe NATO-ja nuk kanë treguar vendosmëri

ndaj Ukrainës. Të gjithë i japin këshilla. Qëndrimi i Perëndimit ndaj Ukrainës nuk mund të konsiderohet miqësi apo solidaritet”, u ka thënë presidenti gazetarëve në Stamboll.

Ai vuri në dukje se “këshillat nuk ndikojnë në zgjidhjen e situatës”. “Ne po flasim me partnerët tanë, duke pyetur se çfarë ka bërë, po bën ose do të bëjë Evropa veç këshillave boshe. Asgjë. Asgjë nuk mund të ndryshohet në këtë mënyrë. Ne do të diskutojmë se çfarë mund të bëhet në samitin e sotëm të NATO-s”, ka deklaruar Erdogan. Ai shprehu bindjen se pas Samitit të Aleancës do të merren vendime konkrete.

## OKB-ja: Pushtimi rus mund të largojë 4 milionë njerëz nga Ukraina

Kombet e Bashkuara kanë thënë se po përgatiten për deri në 4 milionë refugjatë nga Ukraina,

nëse lufta e Rusisë në këtë shtet vazhdon të përshkallëzohet.

Të paktën 100 000 persona janë larguar nga shtëpitë e tyre në Ukrainë, pas nisjes së pushtimit rus më 24 shkurt.

Mijëra janë nisur nëpër shtetet fqinje, Moldavi, Rumania dhe Poloni.

Zëdhënësja e Agjencisë së OKB-së për Refugjatë, Shabia Mantoo, ka thënë se ky institucion është i gatshëm të ofrojë ndihmë për ukrainasit që largohen.

Më herët, gjatë së premtës, Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, ka thënë se ka raportime për të paktën 127 viktima civile në Ukrainë. Prej tyre 25 të vdekur dhe 102 të plagosur si pasojë e sulmeve. Sipas kësaj zyre, numri i viktimave mund të jetë më i lartë. Ndaras Moldavia dhe Rumania kanë thënë se prej shpërthimit të luftës ato kanë pranuar rreth 16 000 dhe 10 000 refugjatë ukrainas, respektivisht.





# Kosova miraton pakon e sanksioneve kundër Rusisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të premten mbledhje në të cilën ka miratuar vendimin për vendosjen e sanksioneve në përputhje me sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Sanksionet konsistojnë në ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës të individëve apo entiteteve të sanksionuara; ndalim udhëtimi në territorin e Republikës së Kosovës për individët e sanksionuar; ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.

Emrat e individëve dhe entiteteve të sanksionuara janë ato të listuara në anekset e akteve rregullative të lartpërmendura të Këshillit të Bashkimit Evropian. Këto sanksione do të jenë në fuqi, deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se kërcënimet e Federatës Ruse për tash e disa muaj ndaj Ukrainës demokratike u bënë agresion ushtarak që për çdo orë po e rrit numrin e viktimave. "I njëjti agresion po vazhdon edhe sot. Ushtria ruse tashmë është futur në kryeqytetin e Ukrainës. Ushtria ruse është ajo e cila këtë agresion e bëri Evropën të tronditet dhe arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare të rimendohet", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se pushtimi rus, tashmë me pasoja tragjike, përveçse sulm ndaj integritetit



territorial dhe sovranitetin të Ukrainës dhe të popullit ukrainas, është edhe sulm ndaj demokracisë dhe lirisë. "Është sulm ndaj vlerave universale të paqes dhe të drejtës së popujve për vetëvendosje. Është sfidim i rendit dhe i unitetit të botës demokratike. Është cenim i sigurisë së përbashkët ndërkombëtare. Sot ditën po e fillojmë duke iu bashkangjitur partnerëve tanë, BE-së dhe ShBA-së në kundërpërgjigjen ndaj agresionit ushtarak të Rusisë, duke miratuar një pako të sanksioneve ndaj saj", është shprehur ai.

Kryeministri Kurti ka thënë se kjo nuk është hera e parë që Republika e Kosovës, duke qenë e rreshtuar me botën

demokratike, i vë sanksione Federatës Ruse. "E në të dy rastet për shkak të agresionit dhe atë ndaj po të njëjtët shtet, Ukrainës. Dëshmi që kjo Rusi që po e shohim sot, nuk është një Rusi e re, por edhe paralajmërim që ajo nuk synon të jetë e re. Në fakt ajo dëshiron të jetë prapë e vjetër, madje të bëhet edhe më e vjetër se Bashkim Sovjetik, pra të bëhet perandori ruse. Prandaj, përgjigja e botës perëndimore dhe demokratike duhet të jetë e bashkuar dhe e vendosur. Dhe e tillë ka qenë. Si pjesë e saj, vendimi ynë i sotëm është bindje vlerore e jona, bashkërendim dhe bashkim me botën e lirë dhe paqedashëse dhe solidarizim me shtetin dhe popullin ukrainas", ka deklaruar Kurti, duke shtuar

se "reagimi ynë i menjëhershëm dhe i parzervë ndaj pushtimit të Ukrainës nga Rusia duhet të lexohet edhe si një mesazh i qartë i orientimit tonë politik dhe diplomatik". "Por, kemi tregues edhe të orientimit të fqinjtit tonë në veri të paralajmëruara më herët. Përafërsisht në të njëjtën kohë kur Kosova ishte një nga 16 shtetet mikpritëse në mesin e 27 vendeve pjesëmarrëse të ushtrimeve ushtarake të NATO-s të kryesuar nga ShBAja, 'Defender Europe 21', Serbia dhe Rusia zhvillonin ushtrime të përbashkëta ushtarake të quajtura 'Joint Response 21' dhe më pas 'Slavic Shield 21'. Pra kur Kosova e aleatët e saj stërviteshin se si të jenë mbrojtësit e Evropës,

fqinji ynë verior dhe Rusia përgatiteshin për kundërpërgjigje të përbashkët dhe për atë që ata e quajnë mburojë sllave. Le të jetë ky një rikujtim për të gjithë", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës është e bashkërenduar dhe duke bashkëpunuar ngushtë me Bashkimin Evropian, NATO-n, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Mbretërinë e Bashkuar për të kundërshtuar luftën pushtuese të Rusisë, por edhe për t'u përballur me ndikimin e pasojat e mundshme në rajonin tonë. "Qëndrojmë bashkë e të bashkuar për paqe dhe siguri, dhe për mbrojtje të demokracisë e të lirisë", është shprehur Kurti.

## Osmani takon partitë opozitare për t'i informuar për veprimet e fundit



PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në takime të ndara ka pritur kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, nënkryetaren e PDK-së, Vlora Çitaku dhe nënkryetarin e AAK-së, Muharrem Nitaj. Në këto takime presidentja Osmani i ka informuar përfaqësuesit e partive politike për situatën aktuale të sigurisë në vend pas zhvillimeve të fundit të krijuara nga agresioni i Federatës së Rusisë ndaj Ukrainës.

Ajo, po ashtu, i informoi partitë opozitare për masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës, veçanërisht ato të sigurisë si dhe

për koordinimin e plotë me partnerët ndërkombëtarë. Presidentja ka falënderuar partitë opozitare për bashkëpunimin si dhe për qëndrimin e unifikuar në përballje me situatën e krijuar. Një ditë më parë presidentja Osmani ka takuar edhe kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, kryeministrin Albin Kurti, ministrat Donika Gërvalla-Schwarz, Xhelal Sveçla dhe Armend Mehaj, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet pas agresionit ushtarak të Federatës Ruse ndaj Ukrainës dhe implikimet për sigurinë dhe stabilitetin e vendit tonë dhe rajonit.





KUVENDI MBAN SEANCË PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

# Opozita i kërkon qeverisë fokusim në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë

Deputetë të partive opozitare kanë kërkuar të premtën nga qeveria që ta ndërpresë dialogun teknik me Serbinë dhe t'i vazhdojë bisedimet e nivelit të lartë me qëllim të arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, si kërkues i kësaj seance, ka thënë se çështja e dialogut është interes kombëtar por, sipas tij, udhëheqësit e sotëm të vendit, që dikur e kundërshtonin ashpër dialogun, sot krenohen për dialogun e teknikëve me tema të ricikluara. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se kjo qeveri e ka marrë shumë seriozisht dialogun me Serbinë

sot krenohen për dialogun e teknikëve me tema të ricikluara. AAK-ja ka propozuar një mocion, me të cilin obligohet qeveria që të mos vazhdojë me këtë lloj dialogu, por të dialogojë për marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse", ka thënë Haradinaj.

Edhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka kërkuar të premtën nga Qeveria e Kosovës që të fokusohet te marrëveshja përfundimtare me Serbinë. "Të insistojë në qëllimin kryesor të dialogut dhe të dialogojë më shumë me partnerët tanë, me shtetet e Quint-it [ShBA-në, Britaninë, Italinë, Gjermaninë dhe Francën], sesa me Serbinë. Vetëm dakordimi me to mund të sigurojë sukses në këtë proces", është shprehur Hoti.

Deputeti nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se është i vetëdijshëm se dialogu Kosovë - Serbi është një proces i vështirë por, pavarësisht kësaj, shtoi ai, qeveria duhet t'i tregojë popullit

të Kosovës se si do të veprojë. Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, ka nisur në vitin 2011, fillimisht për çështje teknike, për të kaluar më vonë në nivel politik midis kryeministrash dhe presidentësh.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shteti i Kosovës nuk është i varur nga njohja e Serbisë. "Ne nuk e kemi shpallur pavarësinë që ta zëvendësojmë varësinë nga Serbia me varësi nga njohja e saj. Kemi treguar që shteti dhe populli i Kosovës janë të përcaktuar në rrugën evropiane dhe euroatlantike, që ne e bëjmë shtetndërtimin demokratik, e bëjmë sundimin e ligjit dhe zhvillimin socio-ekonomik, përkundër problemit që kemi me Serbinë", ka thënë Kurti.

Ai ka pohuar se ka përfunduar koha kur Kosova bën kompromise në pritje të njohjes që vjen në fund. "Pra ka marrë fund koha kur Kosova bën kompromise e kompromise në pritje të njohjes që na vjen në

fund e që nuk vjen asnjëherë. Dhjetë vjet i kemi pasur të kornizuar në një mënyrë të tillë. Vitin e kaluar është bërë ndryshimi, jemi zhvendosur nga koha në hapësirë", ka thënë Kurti, duke shtuar se imazhi ndërkombëtar i Kosovës në raport me Serbinë kurrë nuk ka qenë më i favorshëm se sot. "E keni gati një vit pa asnjë koncesion, prej vitit 2011 nuk ka pasur vite pa koncesione e kompromise, në vitin e kaluar kishim rritje ekonomike, kishim luftim krimi e korrupsioni dhe menaxhim të mirë të pandemisë", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Haradinaj e Kurti gjatë kësaj seance kanë pasur edhe një përplasje për dialogun.

Kurti u është përgjigjur kritikave të kreut të AAK-së, i cili tha se në vend për zgjidhjen përfundimtare, dialogu është kthyer për çështje teknike.

Kurti ka thënë se në kohën sa ka qeverisur vendin, Haradinaj nuk e ka pasur prioritet dialogun, por ka formuar grup me Shpend Ahmetin dhe Fatmir Limajn, duke ia lënë në "dorë" ish-

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Deputetë të partive opozitare kanë kërkuar nga qeveria që ta ndërpresë dialogun teknik me Serbinë dhe t'i vazhdojë bisedimet e nivelit të lartë me qëllim arritjen e marrëveshjes përfundimtare.

Në një seancë parlamentare, të mbajtur të premtën, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, si kërkues i kësaj seance, ka thënë se çështja e

dialogut është interes kombëtar. "Të kalojë në fazën finale dialogu, në marrëveshjen e madhe, me të cilën do të kërkohet njohja reciproke Kosovë - Serbi, në kufijtë ekzistues. Bazuar në tri parimet e dakorduara edhe me negociatorët ndërkombëtarë, pra: integriteti territorial, sovraniteti dhe kushtetueshmëria", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se sot dialogu është kthyer në dialog të teknikëve. "Udhëheqësit e sotëm të vendit, që dikur e kundërshtonin ashpër dialogun,



# Miratohet programi kombëtar për zbatimin e MSA-së 2022-2026

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Të premtën është mbajtur mbledhja e katërt me radhë e Këshillit Ministror për Integrim Evropian (KMIE), i cili është organi më i lartë shtetëror koordinues për integrim evropian. Në këtë mbledhje u diskutua dhe miratua në parim Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026. "Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është proces shtetëror. Kërkon angazhim të të gjitha institucioneve, qoftë ministrive, Kuvendit apo edhe institucioneve të pavarura", ka thënë kryeministri Kurti në

fjalimin e tij në hapje të takimit. Ai ka theksuar se gatishmëria politike dhe performanca e kënaqshme për zbatimin e reformave janë të domosdoshme për fazën e ardhshme të integrimit në Bashkimin Evropian. "Kjo pasi që në mbledhjen më të fundit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, të mbajtur më 7 dhjetor 2021, Kosova ka marrë përsipër zotimin politik që gjatë këtij viti të aplikojë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo pritet të hapë udhë që Kosova të bëhet shtet kandidat për anëtarësim", ka deklaruar Kurti.

Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka paraqitur para të pranishmëve

draftin final të programit, me fokus në reformat kyçe në kuadër të tre blloqeve të këtij dokumenti: kriterëve politike, kriterëve ekonomike dhe standardeve evropiane - kapitujve të negociatave për anëtarësim. Lidhur me këtë ai nënvizoi tri aspekte kyçe. "Së pari, zbatimi i reformave për integrim në BE është parakusht për të kaluar në fazën tjetër të aderimit në BE. Së dyti, zbatimi i këtyre reformave duhet të jetë në përputhje me prioritetet politike dhe gjetjet e Raportit më të fundit vjetor të KE-së për Kosovën, dhe institucionet zbatuese duhet ta fokusojnë punën e tyre në zbatimin e këtyre prioritetëve. Së treti, Kosova duhet të tregojë përparim në zbatimin e

këtyre reformave, në veçanti në pjesën e parë të vitit", ka thënë ai, duke shtuar se pjesa e dytë e vitit do të fokusohet në rrafshin diplomatik dhe përgatitjen e vendimmarrjes politike lidhur me aplikimin për anëtarësim me qëllim të arritjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim. Në pjesën e dytë të mbledhjes, ministrat dhe udhëheqësit e institucioneve të tjera diskutuan specifikisht për reformat nën përgjegjësinë e institucioneve të tyre të parapara në draftin përfundimtar të Programit të MSA-së.

Të gjithë bartësit e masave u zotuan se do të zbatojnë këto reforma në mënyrë të duhur dhe brenda afateve kohore, në

bashkëpunim me zëvendëskryeministrin përgjegjës për integrim evropian dhe me Zyrën e Kryeministrit si institucion koordinues në këtë proces.

Drafti përfundimtar i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së u miratua në parim nga KMIE. Ky program do t'i përcillet për miratim në qeveri, pastaj do t'i dorëzohet Kuvendit për miratim përfundimtar.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së është kornizë gjithëpërfshirëse për përmbushjen e obligimeve të MSA-së dhe reformave të tjera për integrim në BE. Pas miratimit në qeveri PKZMSA 2022-26 do të publikohet për vëmendjen e të gjitha palëve të interesuara.



presidentit Hashim Thaçi këtë çështje të rëndësishme. "Dialogu nuk është marrë më seriozisht sesa nga qeveria jonë. Ne jemi seriozë në dialog e bisedime. E trajtojmë me urgjencë çështjen e të pagjeturve. Në letrën e Blinkenit përmendet çështja e energjisë në veri. Ju deputeti Haradinaj keni qenë kryeministër dhe dialogun ia patët lënë ish-presidentit Thaçi. E patët bërë grupin me Fatmir Limaj e Shpend Ahmetin. Pra nuk mund t'ju marr seriozisht", ka thënë Kurti.

E Haradinaj e ka quajtur mashtrues. "Ky njeri që foli para

meje është mashtrues", është shprehur Haradinaj.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka trajtuar me seriozitet të lartë temën e dialogut me Serbinë, duke listuar edhe një herë pikat që thotë t'u jenë përmbajtur. "Në kuadër të dialogut të zhvilluar ne kemi etabluar disa principe bazë të cilave u jemi përmbajtur gjatë raundeve të bisedimeve qoftë në nivel të krerëve shtetërorë ashtu edhe në atë të kryenegociatorëve", ka thënë Bislimi në Kuvendin e Kosovës.

Më tutje, ai ka thënë se Kosova synon normalizimin e plotë të

raporteve me Serbinë, duke e përmbyll dialogun me njohje reciproke. "Tema e të pagjeturve është nxjerrë nga ky princip për shkak të urgjencës që rrethon të njëjtën dhe për të është biseduar gjatë secilit raund të negociatave", ka thënë Bislimi.

Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq si bartës të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve - nuk janë takuar qysh në korrik të vitit të kaluar. Më 22 shkurt kryenegociatorët e çështjeve teknike, Besnik Bislimi i Kosovës dhe Petar Petkoviç i Serbisë, kanë zhvilluar takime dypalëshe me zyrtarët e BE-së, por nuk ka pasur takim të

përbashkët midis tyre. Një ditë më vonë, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se palët kanë arritur përparim drejt një marrëveshjeje, por nuk ka dhënë më shumë hollësi. Qeveria e Kosovës ka njoftuar të mërkurën se gjatë takimeve është folur për energjetikën në kuadër të një marrëveshjeje ekzistuese.

Më 16 shkurt, i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Uashingtoni ia ka bërë të qartë Qeverisë së Kosovës, se për të arritur deri te njohja reciproke me Serbinë duhet të bëjë

kompromise.

Bisedimet duket se kanë ngecur për shkak të mospajtimit të palëve për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Edhe pse ka një marrëveshje për këtë asociacion qysh në vitin 2013, ai nuk është krijuar. Kurti insiston se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik, kurse Vuçiqi kërkon formimin e tij.

Escobari dhe Lajçaku kanë qëndruar në Kosovë dhe Serbi në fillim të shkurtit, ku kanë bërë thirrje për zbatimin e marrëveshjeve të arritura midis palëve dhe angazhim më të madh të tyre në dialog.



## Kryetari Nura i bashkohet iniciativës për pastrimin e ambientit

SKENDERAJ, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, u është bashkuar punëtorëve të "Eko Natyrës" për pastrimin e ambientit. Ai ka thënë se një

iniciativë e tillë kërkon angazhimin e të gjithëve. "Në Runik, me punëtorët e vyer të 'Eko Natyrës', për të kontribuar rreth pastrimit të ambientit nga mbeturinat, e për t'u

mundësuar qytetarëve jetë më të shëndetshme dhe ambient të pastër. Një iniciativë kaq qëllimshme kërkon angazhimin e të gjithëve. Nëse është e pamundshme për të marrë

pjesë në aksione të tilla, të paktën të mos ketë hedhje të mbeturinave vend e pa vend", ka thënë Nura, duke shtuar se gjërat për ndotësit janë të pashmangshme.



## Vazhdon puna për rilevimin e objekteve, tarracave e rrethojave në Malishevë

MALISHEVË, 25 SHKURT (ER) - Në kuadër të aktivitetit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për matjen e zonave të rrugëve në Malishevë, edhe të premtën, sikurse në ditët e tjera, ka vazhduar puna për rilevimin e objekteve, tarracave dhe rrethojave përgjatë rrugëve kryesore në qytetin e Malishevës. Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Malishevës, Bashkim Krasniqi, bashkë me zyrtarët e drejtorisë po mbikëqyr punën për verifikimin e pronës publike dhe matjet që janë duke u bërë.

"Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër

dhe Pronë po vazhdon punën për verifikimin e pronës publike komunale përgjatë rrugëve kryesore për t'i evidentuar të gjitha ndërtimet, rrethojat apo çfarëdo pengese tjetër e cila vërtetohet që është në zonën e rrugës dhe pronës publike. Ne i lusim të gjithë qytetarët që para çdo investimi ta verifikojnë saktë kufirin e pronës së tyre private dhe asaj shtetërore", ka deklaruar drejtori Krasniqi. Po ashtu, Krasniqi ka thënë se puna në matjet e zonës së rrugëve pritet të përfundojë brenda muajit mars, më pas do të vazhdohet me procedurat për uzurpimet e pronës publike.



## Komuna e Mitrovicës vazhdon realizimin e projekteve me DRC-në



MITROVICË, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të premtën në takim drejtoreshën e DRC-së në Kosovë, Kristen Stec, dhe zyrtarin e projektit të DRC-së në Mitrovicë, Agron Deda. Në këtë takim është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të komunës së Mitrovicës dhe organizatës Danish Refugee

Council (DRC), duke përfshirë projektet që kanë për qëllim mbështetjen e komunitetit ashkali, rom dhe egjiptian në Mitrovicë.

Gjatë këtij takimi është bërë me dije se shumë shpejt do të nënshkruhet edhe një memorandum mirëkuptimi që ka për qëllim mbështetjen e komunës së Mitrovicës për uljen e izolimit socio-ekonomik të

komuniteteve pakicë dhe komuniteteve të cenueshme. Hamza, pasi ka falënderuar përfaqësuesit e DRC-së për kontributin e madh që japin për përkrahje të qytetarëve të Mitrovicës, ka thënë se komuna është e gatshme dhe e hapur për të bashkëpunuar për realizimin e projekteve të përbashkëta të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve.

## EULEX-i i dhuron komunës së Prishtinës tri vetura

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me shefin e misionit të EULEX-it në Kosovë, Lars Gunnar Wigemark, kanë nënshkruar marrëveshje për donacion. Nga kjo marrëveshje Drejtorja e Mirëqenies Sociale e

komunës së Prishtinës dhe dy shkolla, "Shkëndija" dhe Shkolla Speciale "Qendra Burimore - Përparimi", kanë pranuar pajisje të teknologjisë informative dhe tri automjete. "Të gjithë angazhohemi për një të ardhme më të mirë për vendin tonë, ndaj mirëpresim

bashkëpunimin e vazhdueshëm me EULEX-in për ta garantuar transparencën e vizibilitetin në procese, sundimin e ligjit të barabartë për të gjithë dhe shtimin e mundësive për avancimin e qytetarëve", ka thënë kryetari Rama.



## Kryetari i Obiliqit shuan iniciativën dhe kalon në LDK

OBILIQ, 25 SHKURT (ER) - Xhafer Gashi, kryetar i komunës së Obiliqit, ka bërë me dije se ka shuar Iniciativën Qytetare për Obiliqin. Ai ka thënë se tash e tutje aktivitetin politik do ta bëjë në Lidhjen Demokratike të Kosovës

(LDK). "Një vendim i tillë vjen pas konsultimeve dhe bashkëbisedimit të vazhdueshëm brenda strukturave tona dhe bashkimi në një parti si Lidhja Demokratike e Kosovës, vjen si rezultat i përkrahjes së shumicës së

elektoratit të kësaj partie për të tri garat radhazi në zgjedhje lokale si dhe bazuar në parimin e besimit dhe vizionit të përbashkët për realizimin e projekteve madhore për qytetin e Obiliqit", ka thënë Gashi.





## Kosova regjistron tri viktima dhe 140 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të premtën janë regjistruar tri viktima dhe 140 raste të reja me Covid-19. Rastet pozitive kanë dalë pas testimit të 2 060 mostrave. Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 6.79

për qind. Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar edhe se 370 persona janë shëruar derisa 2 763 persona janë ende aktivë me koronavirus. Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë

dhënë mbi 1.8 milion doza të vaksinës. Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 815 155 persona apo 45 për qind e popullsisë. Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë.



## Në 18 raste gjykatat themelore kanë shqiptuar dënime minimale

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Drejtësia Sot, platformë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ka organizuar sot konferencën për medie për paraqitjen e analizës me temën "Trajtimi i rasteve të keqpërdorimit në prokurim publik nga gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë".

Në këtë konferencë është theksuar se, duke qenë se prokurimi publik është nën shënjestër të luftës kundër korrupsionit, për shkak të natyrës komplekse të prokurimit publik me operatorë ekonomikë nga

sfera private, ky proces është parë si një mjet për keqpërdorimin e parasë publike dhe korrupsionit. "Qëllimi i analizës së publikuar është analizimi i veprimeve të aktorëve të gjyqësorit dhe prokurorisë për trajtimin e çështjeve penale në këtë fushë. Nga të gjitha rastet e monitoruara dhe analizuara nga Drejtësia Sot sa i përket keqpërdorimit në prokurim publik janë gjetur 18 raste ku gjykatat themelore kanë marrë aktgjykim lirues, dënues ose refuzues, ndërsa në 5 raste janë gjetur se aktakuzat përmbajnë mangësi në përmbajtjen e tyre", është bërë me dije në analizën e Drejtësia Sot.

"Nga analizimi i 18 rasteve të gjykatave themelore, Drejtësia Sot ka gjetur se pothuajse në të gjitha rastet në përgjithësi janë shqiptuar dënime minimale. Kodi Penal përcakton që dënimi që mund të shqiptohet për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare parimisht është nga 1 deri në 8 vjet burgim, ndërsa për veprën penale të keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik parimisht dënimi parashihet me burgim deri në 5 vjet. Ndërsa në rastet e analizuara sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimeve prijnë dënimet me gjobë të cilat variojnë në lartësi nga 1 500 euro deri në 7 000 euro, pasuar nga

dënimet me kusht të cilat variojnë në kohëzgjatje nga 6 muaj me periudhë verifikuese deri në 1 vit, si dhe dënimet me burgim efektiv të cilat variojnë në kohëzgjatje nga 6 muaj deri në 3 vite", është thënë më tutje në këtë analizë.

Më tej është theksuar se nga analizimi i pesë rasteve të prokurorive themelore, Drejtësia Sot ka gjetur se në aktakuzat e këtyre rasteve prokurorët me rastin e kualifikimit të veprës penale kanë anashkaluar paragrafin 3 të nenit 415 të Kodit Penal, duke mos precizuar vlerën e dëmit të shkaktuar, ose përfitimit të realizuar me rastin e kryerjes së veprës penale të

keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik. "Ndonëse janë bërë ndryshime legislative në vitin 2018, ku vepra penale e keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik është inkuorporuar në Kodin Penal si veprë penale e veçantë, gjatë kësaj analize është gjetur se zbatimi i plotë në praktikë i dispozitës ligjore që përcakton këtë veprë penale, përkatësisht zbatimi i paragrafit që ka të bëjë me ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënie e kontratave në prokurim publik, paraqet sfida për gjyqtarët gjatë implementimit në praktikë", është bërë me dije në këtë analizë.



## Raporti 24-orësh i policisë: Për tejkalim të shpejtësisë janë gjobitur 939 shoferë

PRISHTINË, 25 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës ka bërë me dije se është duke vazhduar kontrollin

dhe mbikëqyrjen e trafikut rrugor. Sipas policisë, vetëm më 24 shkurt, për tejkalim të

shpejtësisë së kufizuar, janë gjobitur 939 shoferë, për mosvendosje të rripit të sigurisë janë

ndëshkuar 145 shoferë dhe për përdorim të telefonit mobil janë ndëshkuar 123 shoferë.





## “Asnji cent ma shumë”, protestuesit kërkojnë anulimin e vendimit për ngritjen e rrymës



PRISHTINË, 25 SHKURT - Grupi organizativ i protestës “Asnji cent ma shumë” ka protestuar të premten me qëllim të anulimit të vendimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) dhe qeverisë për ngritjen e çmimit të energjisë elektrike. Organizatorët kanë thënë se

ky vendim është zhatës dhe do t'i varfërojë qytetarët. “Anulo vendimin”, “Qeveri e popullit apo e privatnikut”, “S’paguaj edhe për veriun”, ishin disa nga shkrimet në pankartat e protestuesve të cilët u nisën nga sheshi “Zahir Pajaziti” drejt qeverisë, e aty situata u tensionua në mes të

tyre dhe zyrtarëve policorë, kur ata tentuan të hyjnë në oborrin e qeverisë për ta lexuar fjalimin e tyre. Pas akuzave dhe shtyrjeve nga ana e policisë, anëtari i grupit organizativ i protestës, Denis Krasniqi, ka thënë se me këtë vendim ZRrE-ja dhe ekzekutivi po dalin në mbrojtje të KEDS-

it. “Ajo që pritej edhe ndodhi. ZRrE-ja bashkë me qeverinë i dolën në krahë një kompanie private KEDS. Qeveria u bë garanci e fitimit të KEDS-it duke i dhënë subvencione 100 milionë euro. E këto para po thotë që i kam dhënë prej buxhetit, por buxheti a është i yni? Vendimi i ZRrE-së për

vendosjen e bllok tarifës dhe rritja e çmimit për të gjithë konsumatorët do të na varfërojë secilin prej nesh. Po rritet çmimi i rrymës, po rriten çmimet e produkteve ushqimore, po rritet çmimi i naftës, vetëm xhepat tanë vetëm po varfërohen”, ka thënë Krasniqi.

## Rritet sërish çmimi i naftës

KIEV, 25 SHKURT - Çmimi i naftës është rritur sërish të premten pas shqetësimeve për shtrëngim të furnizimeve, teksa pushtimi rus i Ukrainës ka hyrë në ditën e dytë.

Çmimi i naftës së papërpunuar është rritur për më shumë se 2 për qind, përkatësisht 101 dollarë për fuçi, ndërkohë që luftimet janë shtuar afër kryeqytetit ukrainas, Kiev. Mirëpo tregjet e aksioneve në Evropë dhe Azi janë stabilizuar pasi investitorët kanë vlerësuar sanksionet e Perëndimit ndaj Rusisë.

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian kanë goditur Rusinë me sanksione. Rusia është eksportuesja e



dytë më e madhe në botë e naftës së papërpunuar pas Arabisë Saudite. Ajo është

edhe eksportuesja më e madhe në botë e gazit natyror.

Evropa merr gati një të tretën e naftës së saj dhe rreth 40 për qind të gazit nga Rusia përmes

gazsjellësve që kalojnë nëpër territorin ukrainas.

Pas prezantimit të sanksioneve janë rritur shqetësimet për rritje të çmimeve të naftës dhe mungesë furnizimesh në nivel botëror.

Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit.

Raketat janë nisur në aeroporte dhe infrastrukturë ushtarake në rreth 25 qytete.

Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar “operacion special” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

## Eksporti në industrinë e drurit këtë vit pritet t'i tejkalojë rekordet paraprake

PRISHTINË, 25 SHKURT - Në studion e emisionit “7 ditë me Panxhën” me Rexhep Ilazin, ekspert nga projekti

Compete që financohet nga USAID-i, është bashkëbiseduar për industrinë e drurit ku, ndër të tjera, u fol për revolucionin

që kjo industri ka përjetuar vitet e fundit si dhe për eksportet që pritët të shënojnë rritje këtë vit. Në

këtë emision u tha se eksporti në industrinë e drurit këtë vit pritët t'i tejkalojë rekordet paraprake.





# Rivalët perëndimorë të Rosisë po e rritin angazhimin e tyre në Ballkan



**Nga Clare NUTTALL**  
"bne IntelliNews"

Dërgimi nga Moska i një të dërguari të nivelit të lartë në Serbi, ndodh jo vetëm në mesin e krizës diplomatike mbi pushtimin e pritshëm të Ukrainës nga Rusia. Ai pason gjithashtu edhe përpjekjet e Francës, Britanisë së Madhe dhe fuqive të tjera perëndimore për të ri-menduar strategjitë e tyre, dhe për të rritur angazhimin me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Lajmi se Nikolai Patrushev, sekretari i Këshillit të Sigurimit të Rosisë, do të pritët në Beograd për bisedime me presidentin Aleksandar Vucic është raportuar gjerësisht nga mediat pro-qeveritare në Serbi. Sipas raportimeve, bisedimet do të fokusohen tek paralajmërimi i Moskës, se mund të ketë rekrutim të mercenarëve nga Shqipëria, Bosnja dhe Kosova për të luftuar në Ukrainë, një pretendim që është mohuar nga zyrtarët e të tria shteteve.

Ndërsa NATO është zgjeruar në Ballkanin Perëndimor, Serbia së bashku me Hungarinë dhe entitetin serb të Bosnjës, Republika Srpska, është tani një nga shtetet e pakta në Evropë, që ka një qëndrim miqësor ndaj Rosisë.

Pavarësisht qëndrimit të dukshëm pro-rus të shumë mediave serbe, Beogradi ka shpallur neutralitetin e tij në konfliktin Rusi-Ukrainë. Vucic e ka afuar vendin e tij më pranë anëtarësimit në BE, duke ruajtur ndërkohë marrëdhënie miqësore

me Rusinë, Kinën, SHBA-në, por edhe me një sërë fuqish të nivelit të dytë si Turqia.

Ndërsa shtetet, përfshirë Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, e kanë lënë pas me vendosmëri sferën rusë të ndikimit duke iu bashkuar NATO-s, Rusia ka synuar që të mbajë aleatët e saj në Beograd dhe Banja Luka, duke mbështetur me vendosmëri Serbinë në fushatën e saj kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, dhe duke i ofruar mbështetje financiare anëtarit serb të presidencës boshnjake me prirje separatiste, Milorad Dodik.

Njëkohësisht, vitet e fundit për Ballkanin Perëndimor ka pasur mesazhe të përziera nga ana e udhëheqësve perëndimorë, pasi procesi i anëtarësimit në BE për shtetet e rajonit ka ngecur në vend. Nën administratën Trump, në Shtëpinë e Bardhë pati përpjekje për ta rigjallëruar procesin e normalizimit të raporteve midis Serbisë dhe Kosovës.

Edhe pse mund të ishte e nxitur më shumë për hir të një fitoreje të shpejtë në politikën e jashtme, përpara zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, ajo përpjekje ndodhi me koston e një shpërbërjeje të dukshme ndërmjet politikës së SHBA-së dhe BE-së në rajon.

Megjithatë, që nga ajo kohë, në Ballkan ka pasur disa ndryshime të rëndësishme nga ana e fuqive kryesore perëndimore të interesuara për rajonin. Administrata e re e SHBA nën presidentin Joe Biden, i është rikthyer një qasjeje shumëpalëshe të politikës së jashtme, duke përfshirë

bashkëpunimin e ngushtë me BE-në për çështje si marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës.

Edhe mbajtësja aktuale e presidencës së Këshillit të BE-së, Franca, synon të ri-angazhohet me rajonin, ndërsa Britania e Madhe po kërkon të ripërcaktojë rolin e saj në politikën e jashtme pas Brexit. Mbetet për t'u parë se si do të ndryshojnë marrëdhëniet e Gjermanisë pas largimit të ish-kancelares Angela Merkel, e cila është shumë e respektuar në rajon.

Nevoja për angazhim ndërkombëtar në këtë rajon, është bërë gjithnjë e më urgjente. Sytë e botës janë tek kërcënimi i luftës në Ukrainë, por Ballkani Perëndimor ka krizën e tij të afërt: shpërbërja e mundshme e Bosnjës, mund të çojë në një konflikt të ri në rajon.

Pas viteve të një retorikës të zjarrtë separatiste nga Dodik, deputetët në entitetin serb të Bosnjës, Republika Srpska, votuan në fund të vitit të kaluar për t'u tërhequr nga ushtria boshnjake dhe institucionet e tjera të nivelit shtetëror. Kjo lëvizje u dënua ashpër nga komuniteti ndërkombëtar, por që atëherë janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm, si miratimi i një ligji për agjencinë e barnave në këtë njësi federative.

Bashkë me mbështetjen e vendosur për Serbinë për Kosovën, Rusia ka ndezur "zjarret" e separatizmit në Bosnje, ku Dodik pretendon se ka mbështetjen e Putin dhe presidentit kinez Xi Jinping, dhe e ka sfiduar hapur autoritetin e

përfaqësuesit të lartë të komunitetit ndërkombëtar. Ndërkohë në vend të qasjes së "ujkut të vetmuar" të viteve administratës Trump, SHBA-ja po bashkëpunojnë tani shumë ngushtë me BE-në. Kjo u pa nga turi i fundit i përbashkët në Beograd dhe Prishtinë nga i dërguari i SHBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe përfaqësuesi special i BE-së Miroslav Lajcak.

"Ballkani Perëndimor, është një rast unik në mesin e mundësive për bashkëpunim transatlantik, pasi BE-ja ka udhëheqjen dhe integrimi mbetet politika e saj kryesore" – shkruan Allison Carragher, studiuese në thimj-tankun Carnegie Europe, në një analizë mbi bashkëpunimin SHBA-Evropë.

Carragher vuri në dukje se "zhvillimet shqetësuese kanë nxitur një përgjigje transatlantike". Sipas saj "problemet aktuale në Ballkanin Perëndimor mbartin një ndjenjë urgjence që nuk është ndjerë që nga vitet 1990". "Çdo përshkallëzim i situatës në kufirin Serbi-Kosovë apo brenda Bosnjës, mund të shkaktojë konflikt të armatosur"- thekson ajo.

Në dhjetorin e vitit të kaluar, Britania caktoi Marshallin Stuart Peach si të dërguarin e posaçëm në Ballkanin Perëndimor, si pjesë e angazhimit të Londrës për stabilitet dhe zhvillim në këtë rajon. Në një debat në parlamentin britanik më 2 dhjetor, politikanët e qeverisë ashtu edhe nga të opozitës, e kritikuan humbjen e interesit për Ballkanin dhe paralajmëruan mbi ndikimin rus në rajon.

Elementët separatistë në Bosnjë janë inkurajuar nga mbështetja e zbehur vitet e fundit për zgjerimin e BE-së, në shumë kryeqytete të Evropës Perëndimore. Të hutuar nga çështje të tilla si kriza e emigrantëve dhe Brexit, oreksi i politikanëve për të pranuar anëtarë të rinj nga Evropa Juglindore është zbehur.

Dekurajimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, arriti kulmin e tij në dhjetorin e vitit 2020, kur liderët e BE-së nuk arritën që të çelin dritën jeshile për fillimin e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, pavarësisht se të dyja këto vende përmbushin të gjitha kushtet e vendosura. Kjo sepse Bullgaria vendosi veton ndaj Shkupit.

Tani programi i presidencës franceze të Këshillit të BE-së flet për "angazhimin në Ballkanin Perëndimor". "Presidenca do të sigurojë vazhdimin e negociatave me vendet candidate, në përputhje me metodologjinë e re të miratuar në konkluzionet samitit të 15 marsit 2020"- thuhet në të.

Edhe në një fjalim në Parlamentin Evropian në janar, presidenti francez Emmanuel Macron premtoi t'i japë këtij rajoni një "perspektivë të qartë të anëtarësimit në union". Por sondazhet më të fundit, kanë treguar se votuesit francezë nuk janë shumë entuziastë për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ndaj rritja e angazhimit francez në rajon, ka gjasa të ndodhë vetëm pas zgjedhjeve presidenciale të muajit prill.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Marmarinos: Duam të bëjmë më të mirën përballë Norvegjisë

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë përgatitjet për duelin me Norvegjinë. Kjo është një sfidë shumë e rëndësishme për "dardanët". Atmosfera në kampin e Kosovës është shumë e mirë, kurse lojtarët po japin maksimumin për të qenë sa më të gatshëm për sfidën ndaj norvegjezëve. Përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Përgatitjet deri më tani kanë shkuar shumë mirë. Fatmirësisht nuk kemi lëndime dhe po përgatitemi maksimalisht për të qenë të

gatshëm për këtë ndeshje. E dimë se si ishte sfida e parë, andaj nuk duhet të bëjmë gabimet e njëjta", është shprehur Marmarinos për faqen zyrtare të FBK-së. Takimin e parë e fitoi Norvegjia me rezultat 86:77. "Për ne është shumë i rëndësishëm ky takim. Është vendimtar. Jemi munduar të përgatitemi siç duhet për këtë sfidë dhe shpresoj të fitojmë. Ajo që mund të them është se do të japim më të mirën tonë, duke shpresuar në rezultat pozitiv", shtoi tutje përzgjedhësi i Kosovës. Ai ka folur edhe për gjasat e Kosovës në Grupin C të rrethit të parë parakualifikues

për "Eurobasket 2025". "Kemi një fitore e një humbje, duke shpresuar se do ta regjistrujmë fitoren e radhës. Ne do t'i marrim ndeshjet një nga një. Sigurisht se synojmë të avancojmë në rrethin e radhës. Besoj se me përkrahjen e tifozëve mund t'ia dalim", ka deklaruar Marmarinos. Në Grupin C, Kosova, Danimarka dhe Norvegjia kanë nga një fitore dhe një humbje. Dardanët kanë një fitore (ndaj Danimarkës 78:73) dhe një humbje (nga Norvegjia 86:77). Vendi i parë kualifikohet tutje dhe vendi i dytë më i mirë nga tri grupet parakualifikuese.



## Drita pret tri pikë nga ndeshja kundër Ballkanit

Ardian Nuhiu dhe Ardian Limani kanë shprehur optimizëm një ditë para derbit me Ballkanin. Ata kanë thënë se Drita është e gatshme ta mposhtë skuadrën nga Suhareka. "Mua më gëzon forma e skuadrës sime. Besoj se të shtunën do të bëjmë një ndeshje të madhe. Nuk do të mungojë disiplina dhe lufta taktike për të marrë më të mirën", ka thënë trajneri Nuhiu



regojnë cilësinë e skuadrave. Ne jemi të gatshëm të shfrytëzojmë çdo dobësi të tyre dhe me ndihmën e tifozëve do ta mposhtim Ballkanin", ka deklaruar Limani. Drita pozicionohet në vendin e tretë me 41 pikë, kurse Ballkani është në vendin e parë me vetëm një pikë më shumë. Në pozitën e dytë është skuadra e Gjilanit, e cila të dielën do ta zhvillojë derbin e dytë për këtë xhiro kundër Prishtinës.

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Skuadra e Dritës, e motivuar pas fitores në mesjavë kundër Malishevës, synon që të njëjtën gjë ta bëjë edhe sot (e shtunë) në derbin kundër Ballkanit. Trajneri Ardian Nuhiu një ditë para ndeshjes ka thënë se gjilanasit do të tentojnë që ta marrin maksimumin nga kjo ndeshje. Ai e ka lavdëruar skuadrën kundërshtare për formën e mirë që po gëzon në

stinorin pranveror. "Të shtunën na pret një përballje e rëndësishme të cilën duhet ta trajtojmë me seriozitet, pasi takohen dy skuadrat që në vitet e fundit e kanë fjalën kryesore në kampionat. Është një sfidë në vete dhe sfidat i dua personalisht sepse na ndihmojnë në trajnerëve dhe futbollistëve. Të gjithë zhvillohemi nga sfidat e vështira. Mua më gëzon forma e skuadrës sime dhe besoj se të shtunën do të bëjmë një ndeshje të madhe. Nuk do të mungojë

disiplina dhe lufta taktike për të marrë më të mirën. Kundërshtari është në formë të mirë dhe ka fituar tri ndeshjet e fundit, por ne jemi të motivuar për të nxjerrë më të mirën. Ndeshja është e rëndësishme, por në asnjë moment vendimtar për titullin e kampionit", ka thënë Nuhiu, i cili më pas ka konfirmuar se në këtë ndeshje mungesa e vetme do të jetë

mbrojtësi Ilir Blakçorri. Në konferencën për medie i pranishëm ishte edhe kapiteni Ardian Limani. Ky i fundit pret tri pikë nga përballja ndaj lideres aktuale të elitës. "Ne si futbollistë e dimë rëndësinë e ndeshjes, prandaj jemi të gatshëm dhe të motivuar. Kur përballesh me një skuadër që është për titull, normalisht se motivi është shumë i lartë. Këto ndeshje

### SUPERLIGA - Java e 22

Të shtunën takohen:  
13:00 Drita - Ballkani  
13:00 Llapi - Malisheva

Të dielën takohen:  
13:00 Ulpiana - Drenica  
13:00 Feronikeli - Dukagjini  
13:00 Prishtina - Gjilani



## Kryetari Kastrati priti në takim klubin e atletikës "Malisheva"

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Fitim Shala, kanë pritur në takim klubin e atletikës "Malisheva", të prirë nga trajneri Adrian Mazreku. Kryetari Kastrati i ka përgëzuar për punën dhe sukseset që po arrijnë

atletët, të cilët gjithashtu po e përfaqësojnë denjësisht edhe Kosovën në arenën ndërkombëtare. Atletët e klubit të atletikës "Malisheva", Olti Bytyçi dhe Enis Bytyçi, së fundmi e kanë përfaqësuar Kosovën në garat ballkanike në salla të mbyllura, që u mbajt në Beograd, duke e shënuar edhe

rastin e parë që ekipi nga Kosova, merr pjesë në gara të këtij niveli, në shtetin fqinj, dhe njëherë duke thyer barrierën, që sportistët tanë deri më tani konsiderohej e paarritshme, për shkaqe politike. Ekipin e Kosovës në këto gara e ka udhëhequr trajneri Adrian Mazreku.

## Barça përballë me Galatasaray, Atalanta ka punë me Leverkusenin

**NYON, 25 SHKURT** - Bayer Leverkuseni do të jetë kundërshtari i Atalantës, ku luan Berat Gjimeshi në 16-shën e Ligës së Kampionëve. Goglat e

shortit të hedhur të premten në Nyon të Zvicrës i përballi gjermanët me ekipin e Gasperinit, i cili do ta luajë ndeshjen e kthimit jashtë. Barcelona do të ketë

punë me gjigantin e Turqisë, Galatasaray. Ndeshjet e para do të luhen më 10 mars, ndërsa ato të kthimit më 17 mars. Ja çiftet e 1/8 së finales: Rangers-

Crvena Zvezda, Braga-Monaco, Porto-Lyon, Atalanta-Bayer Leverkusen, Seville-West Ham, Barcelona-Galatasaray, Leipzig-Spartak Moska,





## Baftiu, 'ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta ndajnë çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros.

Këtë çmim për xhiron e 21-të e ka fituar futbollisti nga radhët e FC Ballkani, Blend Baftiu. "Mesfushori me tipare sulmuese i portokallezinjve ishte lojtari më i mirë i ndeshjes në fitoren bindëse që skuadra e

tij e arriti në shtëpi ndaj Ulpians me rezultat 3:0. Ai shënoi një gol dhe asistoi në golin tjetër, derisa tregoi formë të mirë gjatë tërë ndeshjes, duke e ndihmuar Ballkanin që ta realizojë fitoren e 12 në këtë

edicion. Kjo fitore ia ka mundësuar njëherësh FC Ballkani që ta ruajë pozitën e parë në renditje në BKT Superligë me 42 pikë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e



talentuar të FC Ballkani, Blend Baftiu, e dha Fisnik Morina, menaxher i Degës së BKT-së në Fushë-Kosovë.

## Berisha: Japim maksimumin kundër Norvegjisë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kosova të dielën me fillim nga ora 19:00 përballlet me Norvegjinë në palestrën "Minatori" të Mitrovicës. Sfida është e vlefshme për rrethin e parë parakualifikues për "Eurobasket 2025". Motivimi është i madh në kampin e "dardanëve" duke shpresuar në fitore dhe përkrahjen e tifozëve, siç i kanë mbështetur gjithmonë. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka shprehur optimizëm para kësaj përballjeje. "Ne kemi filluar përgatitjet nga dita e shtunë. Deri më tani kanë shkuar shumë mirë, duke shpresuar se nuk do të kemi lëndime deri në ndeshjen me Norvegjinë. Atmosfera është shumë e mirë dhe të gjithë po e japim më të mirën tonë për të qenë sa më të gatshëm për sfidën ndaj norvegjezëve", është shprehur Berisha për faqen zyrtare të FBK-së, duke shtuar: "Kemi humbur duelin e parë dhe besoj që kësaj radhe mund të triumfojmë. Besoj që kemi ekip të mirë të fitojmë këtë përballje,



që është shumë e rëndësishme për ne". Ai pret përkrahjen e tifozëve. "Tifozët gjithmonë kanë qenë me ne dhe kështu besoj që do të jetë edhe të dielën në Mitrovicë. Për ne është thelbësore dhe jetike përkrahja e tyre. Dardanët na kanë mbështetur gjithmonë. Tifozët janë motivim shtesë për ne", është

shprehur kapiteni Berisha. Në Grupin C, Kosova, Danimarka dhe Norvegjia kanë nga një fitore dhe një humbje. "Dardanët" kanë një fitore (ndaj Danimarkës 78:73) dhe një humbje (nga Norvegjia 86:77). Vendi i parë kualifikohet tutje dhe vendi i dytë më i mirë nga tri grupet parakualifikuese.

## Ronaldo: Dua të luaj edhe për katër apo pesë vjet

MANCHESTER, 25 SHKURT - Cristiano Ronaldo është 37-vjeçar, por shpreson të vazhdojë të luajë futboll edhe për katër ose pesë vjet të tjera. Reprezentuesi portugez ka pasur shumë kritika këtë sezon pavarësisht se ka shënuar 15 gola në 29 ndeshje për Unitedin në të gjitha garat. Megjithatë, kritikantët nuk e zbrapsin Ronaldon, i cili mendon të luajë futboll aktiv dhe në nivele të larta edhe pas moshës 40-vjeçare. "E di që nuk ka shumë vite përpara se të ndaloj së luajturi, shpresoj edhe katër apo pesë, por shpresoj të vazhdoj të fitoj gjëra. Jeta ime ka qenë një udhëtim shumë i bukur. Unë kam lënë gjurmë kudo që kam qenë", ka thënë fillimisht Ronaldo në intervistë për DAZN. "Nuk mendoj se ka ndonjë lojtar në histori që mund të arrijë, mirë, numrat që ai mund të arrijë, por të ketë krenarinë për të thënë 'kudo që



kam qenë, kam lënë gjurmë' dhe kjo më bën të lumtur. Duhet të jesh inteligjent dhe të thuash që kur je tetë vjeç, 20 apo 25, nuk është njësoj si të jesh 35. Kjo është pjekuria, përvoja, intelijenca për të kuptuar

që, ndoshta, humb disa gjëra, por i merr disa gjëra të tjera dhe të ketë ekuilibrin e duhur për të qenë në gjendje të vazhdojë të konkurrojë dhe të jetë në nivelin më të lartë", ka shtuar Ronaldo.

### SHKURT

#### KB Peja emëron trajnerin e ri

Klubi i Basketbollit Peja ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me trajnerin nga Maqedonia e Veriut, Marin Dokuzovski. Trajneri në fjalë konsiderohet si një nga më të mirët në rajon në zejen e tij dhe ka një përvojë të madhe duke udhëhequr reprezentacionin e Maqedonisë së Veriut dhe ekipet, MZT Skopje, Rabotnicki, Lukoil, Sigal Prishtina etj. Ai i ka të fituara shumë kampionate dhe kupa shtetërore në Maqedoni të Veriut, Bullgari dhe Kosovë. Trajneri do ta vazhdojë punën për ta kompletuar ekipin dhe për ta përgatitur për "play-off".

#### UEFA dënon Rusinë, finalja e Ligës së Kampionëve zhvendoset në Paris

Finalja e Ligës së Kampionëve këtë sezon do të luhet në Paris. Ky është vendimi më i ri i UEFA-s pas mbledhjes së sotme të jashtëzakonshme të Komitetit Ekzekutiv. Në fakt, paraprakisht ishte vendosur që finalja e këtij edicioni të mbahet në Saint Petersburg. Mirëpo, për shkak të sulmit ushtarak që e bëri Rusia ndaj Ukrainës, këtij shteti iu hoq e drejta për ta organizuar finalen e Ligës së Kampionëve. Me vendimin e ri finalja do të luhet në Stade de France në Saint-Denis më 28 maj nga ora 21:00.

#### Pele solidarizohet me popullin e Ukrainës

Rusia është duke vazhduar sulmet e njëpasnjëshme në Ukrainë. Kjo ka ndikuar shumë edhe në aspektin sportiv, ku shumë klube dhe legjenda të futbollit kanë reaguar për këtë çështje ndërkombëtare. Së fundmi legjenda braziliane Pele shkroi se i lutet Zotit që të mbizotërojnë paqja, liria dhe dashuria. "Vitet kalojnë, por pak ka ndryshuar që kur isha fëmijë. Tragjeditë që kemi përjetuar tashmë duhet të na kishin mësuar të ndërtonim një botë më paqësore. Unë i dërgoj solidaritetin tim popullit të Ukrainës. Jam në lutje, duke i kërkuar Zotit që të mbizotërojnë paqja, liria dhe dashuria", ka shkruar Pele.

#### Pesë klube të mëdha në garë për Haalandin

Sulmuesi i Borussia Dortmundit, Erling Haaland, po kërkohet nga pesë klube të mëdha evropiane. Largimi i sulmuesit norvegjez nga klubi gjerman duket i pashmangshëm në afatin e ardhshëm kalimtar të verës. Sipas mediumit "Cadena Ser", në tavolinë janë pesë oferta nga Manchester City, Real Madridi, Barcelona, Bayern Muncheni dhe Paris Saint-Germaini. Përveç kësaj, ky medium shton se ka një ofertë të madhe rinovimi edhe nga Dortmundi, por që lojtari nuk e mendon këtë. Aktualisht City thuhet se është i pari në listë, por Real Madridi dëshiron ta bindë Haalandin që të qëndrojë edhe një vit në Dortmund, pastaj të transferohet në "Santiago Bernabeu".

## Djokoviçi tërhiqet nga Indian Wells, shkak mosvaksinimi

Pas eliminimit një ditë më parë nga turneu ATP i Dubai, tenisti serb Novak Djokoviçi ka deklaruar se ende nuk ka vendosur se cili do të jetë event i radhës ku do të luajë. Ai ishte regjistruar në turneun Masters të Indian Wells (nis në

mars), por është tërhequr, pasi vakcina ishte kusht për të marrë pjesë. "Për momentin nuk mund të hyj në Amerikë. Për momentin nuk mund të marr pjesë në turneun e Indian Wells, por të shohim më tej se çfarë do të ndodhë. Të shohim

nëse do të ndryshojë ndonjë gjë në javët në vijim. Nuk kam një datë të saktë se kur do të luaj sërish edhe pse dëshira për të zbritur në fushë është e madhe", ka thënë Djokoviçi. Serbi, pas eliminimit nga Dubai, ka humbur edhe kreun e renditjes

botërore. Nga dita e hënë ai do të jetë numri 2, por duke luajtur kaq pak ai rrezikon të humbasë të tjera pozicione në renditje. Këtë vit ai nuk luajti në Australian Open, pasi u përjashtua si i pavaksinuar.



## PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:  
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe  
populli!  
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!*




*“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1*



*“Drenica para gjyqit” – 2*



*“UÇK-ja para gjyqit” – 3*



*“Na e ban hallall, Kosove” – 4*



*“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,  
UÇK - 5*



*dramë, 6*



*Murtaja e Kuqe-7*

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 02 /3  
Dt: 02.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendër e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 10 orë mësimore;	Vendi i lirë
			Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike me 10 orë mësimore.	Vendi i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
  - Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë.
  - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
  - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
  - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besnik Regjepaj shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikatën –Murator Shkolla Profesionale për zanat, Graçanic.
- "Union Bet" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810027187.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

